

***Ndihmë financiare për të punësuarit e Rafinerisë së Naftës, Ballsh dhe për individët që nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike***

Në shtesë të masave të marra nga qeveria për dhënien e ndihmës financiare me anë të Paketës Financiare nr. 2 (njoftuar me [Njoftimin tone nr. 33](#)) në Fletoren Zyrtare nr. 75, datë 27.04.2020 është publikuar VKM nr. 341, datë 23.04.2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 305, datë 16.04.2020 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19".

Ky Vendim parashikon ndihmë financiare për individët dhe në shumat si më poshtë:

1. **40,000 lekë** për punonjësit e Rafinerisë së Naftës, Ballsh, të cilët figurojnë në listëpagesën e muajit dhjetor 2019 dhe kanë një pagë bruto më të vogël se 100,000 lekë/muaj.
2. **16,000 lekë** për individët që rezultojnë aplikues për ndihmë ekonomike që nga muaji korrik 2019 deri në prill 2020, të cilët nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike, dhe nuk përfitojnë as nga fondi i bashkisë, përveç rasteve kur janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike sipas nenit 15 të ligjit nr.57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".

Drejtoritë e Shërbimit Social Shtetëror do të dërgojnë listat e përfituesve pranë bashkive, të cilat do të njoftojnë familjet dhe do të kryejnë pagesat për përfitimin e ndihmës financiare.

Parashikimet e mësipërme ligjore hyjnë në fuqi duke filluar nga **28.04.2020**.



***Financial assistance for employees of the Ballsh Oil Refinery and for individuals who have not obtained economic assistance***

In addition to the measures taken by the government for providing financial assistance through the Financial Package no. 2 (notified through our [Notification no. 33](#)), in the Official Gazette no. 75 dated 27.04.2020 is published the DCM no. 341, dated 23.04.2020 "On some additions and amendments to the decision no. 305, dated 16.04.2020 of Council of Ministers 'On the procedures, documentation and amount of financial assistance for current employees and for dismissed employees due to Covid-19'".

This decision provides for financial assistance for the following individuals on the following amounts:

1. **ALL 40,000** for employees of the Ballsh Oil Refinery, that are present on the payroll list of December 2019 and obtain a gross salary of less than ALL 100,000/month.
2. **ALL 16,000** for individuals who are applicants for economic assistance from July 2019 to April 2020, who have not received such economic assistance, and do not benefit either from the municipal fund, except for the cases when the individuals have been excluded from the economic assistance scheme according to Article 15 of Law no. 57/2019 "On social assistance in the Republic of Albania".

The Directorates of the State Social Service will send the lists of beneficiaries to the municipalities, which will notify the families and will make the payments for the benefit of the financial assistance.

The abovementioned legal provisions enter into force starting from 28.04.2020